



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 378/10 prot.

Tiranë më 08.07.2022

**URDHËR**

Nr. 107, datë 08.07.2022

**PËR KONTROLLUESIN “TOP CHANNEL” SHA**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “TOP CHANNEL” SHA,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 94, datë 07.06.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “TOP CHANNEL” SHA (në vijim, “Kontrolluesi”), më datë 21.06.2022, me objekt:

- Verifikimi i një ankese të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ pranë kontrolluesit, ka konstatuar se:

1. Kontrolluesi “TOP CHANNEL” sha, është një televizion kombëtar i pavarur i cili ka për objekt kryerjen e veprimtarisë televizive lokale që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit dhe figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër. Pjesë e programeve të kontrolluesit është dhe emisioni investigativ “Top Story”, i cili trajton problematika të ndryshme me përmbajtje politike dhe sociale. Referuar ankesës së paraqitur është konstatuar se në emisionin “Top Story”, të datës 12 Janar 2022, janë bërë publike në kanalin e Kontrolluesit, në platformën Youtube, të dhëna personale të ankuesit konkretisht, të dhëna lidhur me punësimin e tij, numri i

identitetit, emrin e punëdhënësit, paga, si dhe pozicionet që mban ankuesi pranë shoqërive në të cilat rezulton i punësuar.

Nga verifikimet e kryera, është konstatuar se, disa nga të dhënat e bëra publike, në përmbajtje të emisionit gjenden të publikuara gjithashtu edhe regjistra publik të dhënash, si Qendra Kombëtare e Biznesit. Megjithatë, disa prej të dhënave të ankuesit, nuk rezultojnë të jenë publikuar në regjistra publik të dhënash, por të siguruar nga kontrolluesi përmes “*Databazës së pagave të nëpunësve*”, që vjen në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale sipas Ligjit.

Kontrolluesit i është bërë me dije se, Zyra e Komisionerit menjëherë pasi u njoh nga media lidhur me publikimin e një baze të dhënash të qytetarëve të punësuar në sektorin publik dhe atë privat, nëpërmjet një njoftimi për shtyp i ka bërë thirrje të gjithë individëve apo subjekteve publike/private që disponojnë këtë bazë të dhënash personale, të mos e transmetojnë, qarkullojnë apo publikojnë duke rënduar situatën në kuadër të pasojave që mund të vijnë në lidhje me të drejtën për respektimin e jetës private të qytetarëve.

Kontrolluesi me shkresën nr. 239/1 prot., datë 08.06.2022, ka bërë me dije se, ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke hequr nga kanali i saj në platformën Youtube, përkatësisht të dhënat e ankuesit të transmetuara në programin “*Top Story*”, të datës 12.01.2022. Nga verifikimi i kryer mbi përmbajtjen e emisionit, mbas deklarimeve të kontrolluesit rezulton se, të dhënat personale janë fshirë në përmbushje të detyrimeve të Ligjit.

Megjithatë, pavarësisht masave të marra nga ana e Kontrolluesit, është konstatuar gjithashtu se, në përmbajtje të emisionit, edhe mbas fshirjes së të dhënave të ankuesit, vazhdojnë të jenë publike të dhëna të tjera (*emër, mbiemër, numri personal, punëdhënësi, paga, pozicioni i punës*) të shtetasve të tjerë, të siguruar përmes “*Databazës së pagave të nëpunësve*”, në kundërshtim me parimet dhe kriteret e përpunimit të të dhënave personale sipas Ligjit.

Jo vetëm ankuesi, por edhe të gjithë subjektet e tjera të të dhënave personale, të bërë publik në përmbajtje të emisionit, gëzojnë të njëjtat të drejta/garanci dhe përfitojnë të njëjtën mbrojtje nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, lidhur me publikimin e të dhënave të tyre.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në këtë rast, përpunimi i mësipërm (*publikimi i të dhënave personale të qytetarëve në përmbajtje të emisionit*), nuk gjen mbështetje në asnjë parashikim ligjor konkret me qëllim që të konsiderohet i ligjshëm. Kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë/ publikojë të dhënat personale të subjekteve të të dhënave duke respektuar parimin e ligjshmërisë së përpunimit dhe në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit, parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32, pika 1 të Ligjit,

## URDHËROJ:

1. Kontrolluesi të realizojë fshirjen e të dhënave personale të qytetarëve, në cilësinë e subjekteve të të dhënave, të publikuara në përmbajtje të emisionit “Top Story”, të datës 12 Janar 2022.
2. Kontrolluesi mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrës së lënë sipas pikës 1 në këtë Urdhër, brenda 30 ditëve.
3. Afati i sipërpërmendur, fillon nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky Urdhër u shpall sot më datë 0807.2022.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

